



RREPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E KLINËS
OPSTINE KLINA
THE MUNICIPALITY OF KLINA

Duke u bazuar në nenin 13, 58 dhe 34, të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale, Nr-03/L-040, dispozitave të statutit të Komunës së Klinës, nr. 01-110-1232/2010, të miratuar me 31.03.2010, Kryetari i Komunës së Klinës dhe shoqata bamirëse Jetimat e Ballkanit, lidhin, **këtë:**


Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Bashkëfinancimi

në mes të

Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”

dhe

Komunës së Klinës



E lidhur në Klinë, më datën 03/04/2024 në mes të:

1. Jetimat e Ballkanit, e përfaqësuar nga z. Berat Kabashi, Drejtor i përgjithshëm, në njërën anë, si dhe;
2. Komunës së Klinës, të përfaqësuar nga z. Zenun Elezaj, Kryetar i Komunës së Klinës, në anën tjetër.

Neni 1

Kushtet e kësaj marrëveshje

Kjo marrëveshje parasheh ndërtimin e dhjetë (10) shtëpive, sipas formës më çelësa në dorë, për familjet më kushte të rënda ekonomike dhe të cilët nuk kanë kushte minimale banimi. Komuna më qëllim të krijimit të kushtëve sa më të mira për familjet me gjendje të veshtire të banimit, pranon dhe e përkrah lidhjen e kësaj marrëveshje.

Neni 2

Qëllimi i marrëveshjes

1. Komuna me qëllim të krijimit të kushtëve sa më të mira për familjet ne nevojë, pranon dhe e përkrah lidhjen e kësaj marrëveshje.
2. ShB “Jetimat e Ballkanit” në mënyrë vullnetare, të pavarur dhe vullnetë plotë, obligohet dhe zotohet për sigurimin e materialit për ndërtimin e shtëpive skamnore në formën qelsa në dorë.

Neni 3 **Obligimet e Shoqatës**

1. **Shoqata Jetimat e Ballkanit**, është institucioni implementues i këtij projekti i cili parasheh periudhën e ndërtimit të shtëpive sipas programit çelës në dorë.
2. Shoqata Bamirëse "Jetimat e Ballkanit" janë të obliguar të raportojnë për përfundimin e ndërtimit të këtyre shtëpive.
3. Raportimi duhet të bëhet me shkrim para institucioneve të Komunës së Klinës.

Neni 4 **Afati i Realizimit**

Afati i realizimit të qëllimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit është 2 vite nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshje me mundësi vazhdimi me anex të vecante.

Neni 5 **Obligimet e Palëve**

1. Vlera e gjithmbarshme e parashikuar e projektit të ndërtimit të 10 Shtëpive është **300,000.00 € (treqind mijë euro)**.
2. Komuna e Klinës, do të participoj me shumën prej **100,000.00 € (njëqind mijë euro)**.
3. Shoqata Bamirëse Jetimat e Ballkanit do të participojnë me shumën financiare tjetër prej **200,000.00 € (dyqindmijë euro)**, përkatësisht përfundimin e ndërtimit të shtëpive sipas formës çelës në dorë.
4. Shoqata Bamirëse Jetimat e Ballkanit merr për obligim kryerjen e te gjitha procedurave lidhur me ndërtimin e shtëpive sipas kësaj marrëveshje.

Neni 6 **Interpretimi dhe Ndryshimi**

1. Interpretimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit do të bëhet në pajtim me ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit mund të bëhen vetëm me shkrim të nënshkruara nga ana e dy palëve.

Neni 7 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Palët zotohen së do t'i përmbahen kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit dhe së në rast kontesti eventual apo paqartësie në tekstin e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, të zgjidhen më anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe më mirëkuptim.

Neni 8 Shkëputja e Marrëveshjes

E drejta e shkëputjes së njëanshme të kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, do të bëhet në rastet e shkeljeve të obligimeve që janë të përcaktuar me këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit, duke e njoftuar palën tjetër 30 ditë para shkëputjes së Marrëveshjes.

Neni 9 Hyrja në Fuqi

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve nënshkruese.

PALËT NË MARRËVESHJE

Sh.B. Jetimat e Ballkanit



Berat Kabashi
Drejtor Gjeneral



Zenun ELEZAJ
Kryetar i Komunës